

Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Nëntor 2024

Tiranë, më 10 Dhjetor 2024: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Nëntor 2024, arriti 117,6, kundrejt muajit Dhjetor 2020.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Nëntor 2024 është 2,0 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 3,9 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Nëntor 2024, krahasuar me Tetor 2024 është -0,02 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Tetor është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,11 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,27 pikë përqindje. Gjithashtu, çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” ndikuan me +0,25 pikë përqindje, çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” me +0,19 pikë përqindje, çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” me +0,15 pikë përqindje, çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,12 pikë përqindje, çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,11 pikë përqindje, çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” me +0,10 pikë përqindje, çmimet e grupit “Shëndeti” me +0,04 pikë përqindje, çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” me +0,03 pikë përqindje, çmimet e grupit “Komunikimi” me +0,02 pikë përqindje dhe çmimet e grupit “Transporti” me -0,34 pikë përqindje.

Për publikim 10/12/2024

Vijon

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Nëntor 2023, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë” me 5,7 %, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 4,0 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 3,8 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 3,3 %, “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 3,2 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 1,9 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 1,8 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1,4 %, “Shëndeti” me 1,1 %, “Komunikimi” dhe “Shërbimi arsimor” me 0,8 % secili. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” shënuan ulje me 5,4 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” patën një rritje me 7,5 %, pasuar nga nëngrupet “peshk” me 4,2 %, “mish” me 3,9 %, “qumësht, djathë dhe vezë” me 2,8 %, “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe mbëlsira” me 1,9 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Tetor 2024, çmimet e grupit “Transporti” shënuan ulje me 0,5 %, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0,3 %, “Argëtim dhe kulturë” me 0,2 %, “Shëndeti” me 0,1 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” u rritën me 0,6 %, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,3 %, Pije alkoolike dhe duhan, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,2 % secili, “Shërbimi arsimor” me 0,1 %

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

| Kodi | Grupet | Peshat | 11-23 | 12-23 | 01-24 | 02-24 | 03-24 | 04-24 | 05-24 | 06-24 | 07-24 | 08-24 | 09-24 | 10-24 | 11-24 |
|------|---|------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| | Gjithsej | 100 | 115,3 | 115,8 | 116,4 | 116,8 | 117,3 | 117,1 | 116,8 | 116,4 | 116,2 | 116,8 | 117,5 | 117,6 | 117,6 |
| 1 | Ushqime dhe pije joalkoolike | 34,6 | 128,1 | 129,6 | 131,2 | 132,2 | 133,4 | 132,5 | 131,5 | 130,0 | 129,0 | 130,3 | 132,1 | 132,6 | 132,2 |
| 2 | Pije alkoolike dhe duhan | 4,9 | 111,2 | 112,4 | 112,5 | 112,6 | 112,9 | 113,4 | 113,6 | 114,0 | 114,3 | 114,7 | 114,8 | 115,2 | 115,4 |
| 3 | Veshje dhe këpuçë | 3,8 | 108,2 | 108,7 | 108,9 | 108,9 | 108,8 | 108,9 | 109,2 | 109,6 | 110,1 | 110,8 | 111,4 | 111,8 | 112,5 |
| 4 | Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji | 20,0 | 106,8 | 107,5 | 107,5 | 107,6 | 107,7 | 107,6 | 107,7 | 107,7 | 107,8 | 108,1 | 108,2 | 108,0 | 108,3 |
| 5 | Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë | 7,4 | 112,5 | 112,6 | 113,4 | 113,8 | 113,9 | 114,2 | 114,8 | 115,1 | 115,1 | 115,5 | 116,0 | 116,1 | 116,3 |
| 6 | Shëndeti | 3,5 | 103,1 | 103,2 | 103,5 | 103,9 | 103,9 | 104,0 | 104,0 | 104,0 | 104,0 | 104,1 | 104,1 | 104,3 | 104,2 |
| 7 | Transporti | 6,2 | 114,3 | 111,8 | 111,4 | 111,2 | 111,6 | 111,8 | 110,5 | 110,0 | 110,1 | 109,3 | 109,2 | 108,6 | 108,0 |
| 8 | Komunikimi | 3,0 | 104,9 | 104,9 | 104,9 | 104,9 | 104,9 | 104,9 | 105,0 | 105,0 | 105,1 | 105,6 | 105,8 | 105,8 | 105,8 |
| 9 | Argëtim dhe kulturë | 2,2 | 111,3 | 111,3 | 111,4 | 111,6 | 112,0 | 113,2 | 113,9 | 113,9 | 113,3 | 115,3 | 117,5 | 117,9 | 117,7 |
| 10 | Shërbimi arsimor | 3,3 | 105,2 | 105,2 | 105,2 | 105,1 | 105,1 | 105,1 | 105,2 | 105,1 | 105,2 | 105,4 | 105,8 | 105,9 | 106,0 |
| 11 | Hotele, kafene dhe restorante | 5,6 | 113,3 | 113,5 | 113,7 | 113,7 | 113,8 | 114,0 | 114,1 | 114,2 | 114,7 | 115,0 | 115,0 | 115,3 | 115,3 |
| 12 | Mallra dhe shërbime të ndryshme | 5,5 | 106,0 | 106,6 | 106,8 | 107,2 | 107,3 | 107,4 | 107,6 | 107,5 | 107,6 | 107,8 | 107,9 | 107,9 | 108,1 |

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

| Kodi | Grupet | 11-23/11-22 | 12-23/12-22 | 01-24/01-23 | 02-24/02-23 | 03-24/03-23 | 04-24/04-23 | 05-24/05-23 | 06-24/06-23 | 07-24/07-23 | 08-24/08-23 | 09-24/09-23 | 10-24/10-23 | 11-24/11-23 |
|------|---|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| | Gjithsej | 3,9 | 4,0 | 3,4 | 2,6 | 2,3 | 2,1 | 2,2 | 2,1 | 2,1 | 2,0 | 1,9 | 1,9 | 2,0 |
| 1 | Ushqime dhe pije joalkoolike | 7,1 | 6,7 | 5,3 | 2,7 | 2,0 | 1,5 | 1,9 | 2,0 | 1,9 | 2,4 | 2,7 | 3,1 | 3,2 |
| 2 | Pije alkoolike dhe duhan | 3,5 | 4,3 | 3,9 | 3,7 | 3,3 | 3,3 | 3,1 | 3,3 | 3,1 | 3,6 | 3,5 | 3,6 | 3,8 |
| 3 | Veshje dhe këpuçë | 2,9 | 3,0 | 3,3 | 3,4 | 3,3 | 3,4 | 3,2 | 3,2 | 3,3 | 3,9 | 3,6 | 3,5 | 4,0 |
| 4 | Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji | 1,9 | 2,6 | 2,3 | 2,4 | 2,4 | 2,3 | 2,2 | 2,2 | 2,2 | 1,5 | 1,5 | 1,2 | 1,4 |
| 5 | Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë | 4,8 | 4,6 | 5,0 | 4,7 | 4,2 | 3,5 | 3,7 | 3,7 | 3,5 | 3,5 | 3,6 | 2,9 | 3,3 |
| 6 | Shëndeti | 1,0 | 1,2 | 1,6 | 1,9 | 1,9 | 1,7 | 1,7 | 1,7 | 1,5 | 1,4 | 1,1 | 1,2 | 1,1 |
| 7 | Transporti | -4,0 | -3,3 | -4,3 | -1,6 | -0,3 | 1,0 | 1,1 | 0,9 | 0,3 | -3,1 | -4,5 | -5,3 | -5,4 |
| 8 | Komunikimi | 0,5 | 0,3 | 0,3 | 0,3 | 0,2 | 0,0 | 0,1 | 0,1 | 0,2 | 0,6 | 0,8 | 0,8 | 0,8 |
| 9 | Argëtim dhe kulturë | 6,0 | 5,4 | 5,0 | 4,9 | 3,8 | 4,4 | 3,7 | 1,9 | 2,2 | 4,0 | 4,6 | 5,0 | 5,7 |
| 10 | Shërbimi arsimor | 2,6 | 2,3 | 2,2 | 2,2 | 2,3 | 2,2 | 2,2 | 2,1 | 2,2 | 2,2 | 0,9 | 0,7 | 0,8 |
| 11 | Hotele, kafene dhe restorante | 4,3 | 4,4 | 4,0 | 3,8 | 3,5 | 3,2 | 2,4 | 2,2 | 1,9 | 1,8 | 1,8 | 1,8 | 1,8 |
| 12 | Mallra dhe shërbime të ndryshme | 2,8 | 3,4 | 3,4 | 3,5 | 3,3 | 2,7 | 2,5 | 2,2 | 2,1 | 2,1 | 1,9 | 1,9 | 1,9 |

%

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

| Kodi | Grupet | 11-23 | 12-23 | 01-24 | 02-24 | 03-24 | 04-24 | 05-24 | 06-24 | 07-24 | 08-24 | 09-24 | 10-24 | 11-24 |
|------|---|-------------|------------|------------|------------|------------|-------------|-------------|-------------|-------------|------------|------------|------------|--------------|
| | Gjithsej | -0,2 | 0,5 | 0,5 | 0,3 | 0,4 | -0,2 | -0,2 | -0,4 | -0,2 | 0,5 | 0,6 | 0,1 | -0,02 |
| 1 | Ushqime dhe pije joalkoolike | -0,4 | 1,1 | 1,3 | 0,7 | 1,0 | -0,7 | -0,7 | -1,1 | -0,7 | 1,0 | 1,4 | 0,3 | -0,3 |
| 2 | Pije alkoolike dhe duhan | 0,0 | 1,0 | 0,1 | 0,1 | 0,2 | 0,5 | 0,2 | 0,3 | 0,3 | 0,4 | 0,1 | 0,3 | 0,2 |
| 3 | Veshje dhe këpucë | 0,2 | 0,5 | 0,2 | -0,1 | 0,0 | 0,1 | 0,2 | 0,4 | 0,5 | 0,6 | 0,5 | 0,4 | 0,6 |
| 4 | Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji | 0,1 | 0,6 | 0,0 | 0,1 | 0,1 | 0,0 | 0,1 | 0,0 | 0,0 | 0,4 | 0,1 | -0,2 | 0,3 |
| 5 | Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë | -0,2 | 0,1 | 0,7 | 0,4 | 0,1 | 0,2 | 0,5 | 0,2 | 0,1 | 0,3 | 0,5 | 0,1 | 0,2 |
| 6 | Shëndeti | 0,0 | 0,1 | 0,3 | 0,4 | 0,0 | 0,1 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,1 | 0,0 | 0,1 | -0,1 |
| 7 | Transporti | -0,3 | -2,1 | -0,4 | -0,2 | 0,3 | 0,2 | -1,1 | -0,4 | 0,0 | -0,7 | -0,1 | -0,5 | -0,5 |
| 8 | Komunikimi | -0,1 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,1 | 0,0 | 0,1 | 0,4 | 0,2 | 0,0 | 0,0 |
| 9 | Argëtim dhe kulturë | -0,9 | 0,0 | 0,1 | 0,2 | 0,4 | 1,1 | 0,6 | 0,0 | -0,5 | 1,8 | 1,9 | 0,4 | -0,2 |
| 10 | Shërbimi arsimor | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,1 | 0,2 | 0,4 | 0,1 | 0,1 |
| 11 | Hotele, kafene dhe restorante | 0,0 | 0,2 | 0,2 | 0,0 | 0,1 | 0,2 | 0,1 | 0,1 | 0,4 | 0,3 | 0,0 | 0,2 | 0,0 |
| 12 | Mallra dhe shërbime të ndryshme | 0,1 | 0,5 | 0,2 | 0,3 | 0,1 | 0,1 | 0,1 | 0,0 | 0,1 | 0,2 | 0,1 | 0,0 | 0,2 |

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2022.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.